# DËSHMI ARKIVI

**A-477016**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rashica, protagonisti kryesor i Kosovës në dy sfidat e fundit ndaj Izraelit |
| ADRESA | `https://albeu.com/sport/rashica-protagonisti-kryesor-i-kosoves-ne-dy-sfidat-e-fundit-ndaj-izraelit/1031355/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 16:39:33 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 16:34:12 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `f468c8e487bd03cf7637ba477ef3cf1c1e28ca337b537cdf620013aad5b8296c` |
| TEKSTI | `88b86e85c9d7141a3c1f6de9d17a56c178281abdd42825aaaebaa6e76d445d77` |
| PAMJA | `e9ba69cf9168854271feb1314c5a00174c1953c4ef005bba7a0ec0b393a13ea4` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `c970709ef8828b1bff579e0bf77709f4afca08bed534ebc7d0a93db4f4dbc442` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `18c690da73dc1a573fdd24afdc5abc524a645e4949def315e2ee13951ef2125f` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/c970709ef8828b1bff579e0bf77709f4afca08bed534ebc7d0a93db4f4dbc442`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Rashica, protagonisti kryesor i Kosovës në dy sfidat e fundit ndaj Izraelit



Milot Rashica ka luajtur një rol të rëndësishëm në dy ndeshjet e fundit të Kosovës kundër Izraelit. Të enjten, në Debrecen të Hungarisë, ku dy përfaqësueset do të përballen në Ligën e Kombeve B, vushtrriasi do të synojë të vazhdojë paraqitjet e tij vendimtare ndaj këtij kundërshtari.

Takimi i parë mes Kosovës dhe Izraelit u zhvillua më 25 mars 2023 në Tel Aviv dhe u mbyll në barazim 1-1. Rashica ishte në fushë gjatë gjithë ndeshjes dhe pati ndikim të drejtpërdrejtë në golin e shënuar nga Kosova.

Në minutën e 36-të, goditja e Rashicës u devijua nga Eli Dasa dhe topi përfundoi në portën izraelite. Edhe pse goli iu regjistrua si autogol mbrojtësit të Izraelit, aksioni i nisur dhe goditja e kosovarit ishin thelbësore për epërsinë e Dardanëve.

Rashica pati ndikim të drejtpërdrejtë edhe në përballjen e dytë, e cila u zhvillua më 12 nëntor 2023 në stadiumin “Fadil Vokrri”. Në atë rast, sulmuesi nuk pati nevojë për ndihmën e një lojtari kundërshtar për të shënuar.

Futbollisti nga Vushtrria realizoi golin e vetëm të takimit gjatë pjesës së parë, duke i dhënë Kosovës fitoren 1-0. Ai qëndroi në fushë për 78 minuta dhe u bë sërish figura që përcaktoi rezultatin e ndeshjes.

Në këtë mënyrë, Rashica ka qenë i përfshirë në të tre golat që Kosova ka shënuar në dy përballjet e para me Izraelin. Në Tel Aviv ai krijoi aksionin që solli autogolin, ndërsa në Prishtinë shënoi vetë golin e fitores. Të dyja paraqitjet e tij patën ndikim të drejtpërdrejtë në rezultat.

Pas afro tri vitesh nga triumfi në “Fadil Vokrri”, Kosova do ta presë sërish këtë sfidë ndaj Izraelit, por kësaj here në kushte të tjera. Ndeshja është pjesë e Ligës së Kombeve, ndërsa Izraeli do të figurojë si vendas në Debrecen.

Rashica, ndërkohë, ka pasur pak minuta në këtë edicion të Ligës së Kombeve. Në dy ndeshjet e para të Kosovës ai është aktivizuar vetëm për 17 minuta, të gjitha në fitoren 1-0 ndaj Irlandës. Pas futjes së tij në lojë në atë

të fundit/


Sylvester Stallone rrëfen betejën me fizikun: “U bëra bulimi…


Rashica, protagonisti kryesor i Kosovës në dy sfidat e fundit ndaj…


LDK-ja propozon përfaqësuesit e saj për 16 komisione…


Stresi merr vendimin, largohet nga rrjetet sociale, ja çfarë njoft…


Besian Mustafa mungoi në votimin e deklaratës së Kuvendit për…


A do të pësojë ndryshime ligji për Gjykatën Speciale?


VV-ja merr drejtimin e tetë komisioneve parlamentare

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

takim, Kosova shënoi golin që vulosi triumfin. Në duelin kundër Austrisë, ai nuk u aktivizua.

Mbetet për t'u parë nëse përzgjedhësi Franco Foda do t'i besojë sërish Rashicës të enjten dhe nëse ai do të ndikojë përsëri në rezultatin e Kosovës. Dy përballjet e mëparshme tregojnë se Izraeli është një kundërshtar ndaj të cilit vushtrriasi ka qenë vendimtar, fillimisht duke krijuar aksionin e golit dhe më pas duke shënuar vetë.

Shtuar më 28.09.2026 18:34

Tags: Kombëtarja e izraelit , Kombëtarja e kosovës , Liga e Kombeve


Tuchel shpjegon si zemërimi e ndihmon Bellinghamin të japë më t…


VIDEO/ Nga Tirana te rivali kryeqytetas, Bernard Berisha viziton ish-klubin…


Më janë marrë shtatë tituj" – Florentino Perez përballet me Barcelonën në gjykatë


Përplasje dhe akuza për racizëm pas fitores së Irlandës ndaj Izraelit


E ardhmja e Haaland në La Liga varet nga vendimi për Manchester Cityn


Debat i ashpër pas Izrael-Irlandë: "Duhet të të vijë turp për atë që po ndodh …


Kosova përballet sërish me Izraelin pas afro tre vjetësh, me katër pikë nga dy…


Real Madridi vëzhgon nga afër të ardhmen e Alexis Mac Allister te Liverpooli

© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko... Kërko

**Kryesore**
Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

**Kategori**
Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

**Linqet**
Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

**Tags**
Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

**Moti**
Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.